

REXHEP QOSJA OSE KORIFEU I KRITIKËS SHQIPE

Agim Vinca

Prishtinë

KUD 92:891.983

Është një nder për kulturën tonë që brenda një viti - dhe pikërisht në këtë vit (1996) - bie përvjetori i tre prej përfaqësuesve më të mëdhenj të gjallë të saj: 60-vjetori i lindjes së Ismail Kadaresë, Adem Demaçit dhe Rexhep Qosjes. Datat e tilla, të koncentruara në një interval kohor prej vetëm disa muajsh, i kanë të rralla edhe letërsitë dhe kulturat shumë më të mëdha e më të zhvilluara se ç'është letërsia dhe kultura jonë, ndërsa një treshe të këtillë intelektualësh do ta lakmonin edhe popuj shumë më të mëdhenj e më të zhvilluar se ç'jemi ne shqiptarët.

Për veprën krijuese dhe jetësore të shkrimtarëve dhe të intelektualëve të mëdhenj, siç janë: Kadareja, Demaçi dhe Qosja mund të flitet në çdo kohë, e jo vetëm në raste përvjetorësh, mirëpo 60-vjetori i lindjes është, megjithatë, një rast që nuk duhet lëshuar pa thënë ndonjë fjalë për punën krijuese të secilit prej tyre veç e veç e, *à propos*, edhe bashkërisht, aq më parë kur dihet se ata, që të tre, nuk janë mbyllur brenda suazave të profesionit a vokacionit të tyre kryesor - krijimtarisë letrare, por janë legjitimuar, kush më shumë e kush më pak, edhe si luftëtarë të çështjes mjerisht ende të pazgjidhur kombëtare shqiptare, duke u bërë kështu qysh për së gjalli, sinonim i synimeve më të larta të këtij populli.

Akademik Rexhep Qosja, "shkrimtari më i madh ndër shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të vendit" (Shqipërisë-A.V.),¹ siç prezentohet në parathënien e botimit frëngjisht të romanit "*Vdekja më vjen prej syve të tillë*", është pa dyshim një nga personalitetet më të shquara të letërsisë, të kulturës dhe, madje, edhe të historisë së re shqiptare. Kritik letrar e historian i letërsisë; prozator e dramaturg; eseist e publicist; intelektual kritik dhe

¹ I s m a i l K a d a r e, *L'écrivain d'un peuple interdit* (Shkrimtar i një populli të ndaluar), parathënie e romanit *La mort me vient de ces yeux-là*, "Gallimard", Paris 1994, f.7.

polemist *sui generis*, Rexhep Qosja është një personalitet i gjithanshëm e poliedrik, kurse vepra e tij letrare e shkencore është jo vetëm e gjerë dhe e shumanshme, por edhe e madhe në kuptimin e plotë të fjalës - edhe si vëllim, edhe si vlerë - dhe me ndikim të madh jo vetëm në jetën letrare e kulturore, por edhe në rrjedhat jetësore shqiptare në përgjithësi.

Rexhep Qosja u shfaq në skenën tonë letrare në moshë relativisht të vonë, në gjysmën e dytë të viteve '60, kur letërsia shqipe në Kosovë ishte ende në fazën e saj fillestare, kurse inteligjencia e re dhe e pakët krijuese shqiptare në ish-Jugosllavi sapo kishte filluar të çlirohej pak a shumë nga ankthi dhe trysnia e dhunës policore rankoviqiste. Ndryshe nga krijuesit e tjerë të brezit të tij, të ardhur nga anë të ndryshme në Prishtinë, djaloshi nga Vuthaj e filloi krijimtarinë letrare në mënyrë pak a shumë jo të zakonshme për mjedisin tonë letrar, duke shkruar jo vjersha e tregime (më vonë dha prova serioze në prozë e dramaturgji), por kritika e recensione. Pas disa shkrimeve të botuara në faqet e shtypit dhe të periodikut letrar, posaçërisht në revistën "Përparimi", ai doli para lexuesve me librin e tij të parë me titull "*Episode letrare*" (1967), libërth ky që nuk mbeti një episod i vetmuar në jetëshkrimin krijues të autorit të tij, i cili, falë punës së tij të pandërprerë e këmbëngulëse, por edhe rrethanave më të favorshme për punë shkencore e krijuese që u krijuan në Kosovë në vitet '70 (krijimi i institucioneve shkencore, hapja e mundësive për hulumtim e botim etj.), arriti që brenda një kohe relativisht të shkurtër, për më pak se 30 vjet, të botojë një numër të madh veprash (mbi 20 vepra letrare, shkencore e publicistike), pjesa dërrmuese e të cilave i takojnë fushës së kritikës, të eseistikës dhe asaj historiko-letrare, në mesin e të cilave vlen të përmenden: «*Dialogje me shkrimtarët*» (1968), "*Kritika letrare*" (1969), «*Kontinuitete*» (1971), "*Asdreni - jeta dhe vepra e tij*" (1971), "*Panteoni i rralluar*" (1973), "*Shkrimtarë dhe periudha*" (1975), "*Anatomia e kulturës*" (1976), "*Prej tipologjisë deri te periodizimi*" (1979), "*Nocione të reja albanologjike*" (1983), "*Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I,II,III*" (1984-1986) dhe "*Porosia e madhe*" (1986).

Përveç këtyre ai ka botuar edhe dy antologji: "*Antologjinë e lirikës shqipe*" (1970), që vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite e vetmja antologji integrale e poezisë shqipe prej De Radës e deri në ditët e sotme dhe "*Antologjinë historike të letërsisë shqipe*" (1985), si edhe një vepër polemike - librin "*Morfologjia e një fushate*" (1980) dhe ka përgatitur për shtyp veprat e plota të Asdrenit, të Naimit, vëllime me poezi të zgjedhura të poetëve të njohur bashkëkohorë si Dritëro Agolli, Rrahman Dedaj etj.

Çka e karakterizon individualitetin e akademik Rexhep Qosjes si kritik letrar dhe studiues i letërsisë?

Rexhep Qosja është krijues me talent të rrallë dhe me kulturë të gjerë letrare; me formim solid teorik dhe me shije të formuar estetike; me guxim të

rrallë intelektual e parime të qëndrueshme etiko-morale; me aftësi të jashtëzakonshme analitike e mundësi të mëdha shprehëse, cilësi këto që i stolisin rëndom kritikët e mëdhenj, çfarë është pa mëdyshje edhe kritiku ynë.

Me emrin e tij lidhet koncepti pak a shumë i ri mbi letërsinë në mendimin tonë kritik jo si pasqyrim i realitetit, por si krijim gjuhësor artistik, që ka veçoritë e veta specifike.

Me emrin e tij lidhet konsolidimi i kritikës letrare shqipe në Kosovë dhe modernizimi i shkencës letrare shqiptare në përgjithësi.

Rexhëp Qosja është i pari kritik letrar shqiptar i pasluftës që iu kundërvu kategorikisht doktrinë dogmatike të realizmit socialist, që ishte rrymë zyrtare në shtetin amë, në Shqipëri, madje edhe në kohën kur në Tiranë, për shkak të bindjeve apo të diktatit, i thureshin himne asaj doktrine, kurse në Prishtinë kryesisht heshte për të për shkaqe konformiste, pra në kohën kur prej bashkëkombësve të vet mund të keqkuptohej e të kritikohej, ashtu siç kritikohet sot për qëndrimin kritik ndaj ngjarjeve dhe proceseve aktuale politike e shoqërore në botën shqiptare.

Rexhëp Qosja është i vetmi studiues shqiptar i pasluftës, me përjashtim të ndonjërit nga ata që kanë jetuar e krijuar në botën e jashtme, i cili qysh në kohën kur Gjergj Fishta dhe vepra e tij ishin në indeks, e quante atë «poet të madh kombëtar»,² kurse kryeveprën e tij, «Lahutën e Malsisë» - enciklopedi të shpirtit shqiptar, ashtu siç është pothuajse i vetmi studiues shqiptar që sot, d.m.th.pas vitit 1990, kur mohuesit e djeshëm ndodh ta fetishizojnë Fishtën, sikurse edhe të ekskomunuarit e tjerë, flet për të në mënyrë kritike,³ duke mos i heshtur as gabimet e tij, ashtu siç vepron edhe me Konicën e të tjerë.

Rexhëp Qosja është kritiku i parë shqiptar, në shkrimet kritike, eseistike dhe historiko-letrare të të cilit pothuajse që nga fillimi dhe veçanërisht nga viti 1968 e këndeje, kur fillon procesi i integritit kulturor dhe shpirtëror shqiptar, i ndërprerë përsëri në vitin 1981, artikullohet qartë vetëdija mbi rolin e krijimtarisë letrare dhe kulturore në përgjithësi në këtë proces historikisht të pandalshëm. Kjo vetëdije - se ekziston vetëm një letërsi dhe kulturë kombëtare shqiptare, që ka një traditë të përbashkët e unike dhe që krijohet në një gjuhë të përbashkët letrare, e shprehur teorikisht në esetë e tij mbi traditën, konkretizohet praktikisht në secilën nga veprat e tij. Është e kuptueshme, prandaj, që në veprat e tij, duke filluar që nga «Dialogjet...» e këndeje, hasen pranë e pranë Migjeni dhe Esad Mekuli, Hivzi Sulejmani dhe Jakov Xoxa, Josip Relat dhe Kolë Jakova, Anton Pashku dhe Ismail Kadareja e kështu me radhë.

² R e x h e p Q o s j a, *Përsiatje rreth poetëve të mëdhenj*, në *Kontinuitete*, "Rilindja", Prishtinë 1971, f.227-241.

³ R e x h e p Q o s j a, *Gjergj Fishta dhe çështja shqiptare*, në *Strategjia e bashkimit shqiptar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 1992, f.47-62.

Rexhep Qosja është i vetmi kritik letrar shqiptar, i cili, pothuajse qysh në fillim të karrierës së tij, duke afirmuar vlerat e vërteta artistike, qofshin ato të shkrimtarëve të traditës apo të letërsisë bashkëkohore, iu kundërvu në mënyrë permanente dogmatizmit, skematizmit, uniformizmit, varfërisë tematike e shprehjes retorike dhe tendencave të tjera të ngjashme frenuese, ashtu siç iu kundërvu, gjithnjë duke afirmuar të renë e modernen, edhe pseudo-modernizmit, snobizmit, hermetizmit, epigonizmit, esteticizmit shterp dhe shfaqjeve të tjera gjithashtu frenuese.

Krijues me guxim të madh intelektual dhe me energji të pashtershme krijuese, Rexhep Qosja është shkrimtar dhe kritik jokonformist, që aq shumë i kanë munguar letërsisë dhe kulturës sonë sidomos në periudhën e utopisë socialiste. Ndryshe nga kritika e mëparshme shqiptare, që ishte kritikë kryesisht ideologjike ose impresioniste dhe që merrej kryesisht me përmbajtjen e veprës letrare dhe porosinë e saj ideore, Rexhep Qosja si kritik letrar do t'i kushtojë kujdes të veçantë strukturës artistike të veprës letrare, përkatësisht poetikës së saj.

I vetëdijshëm se funksioni primar i letërsisë si art është funksioni i saj estetik dhe se veprën letrare e bën të tillë vlera e saj artistike, Rexhep Qosja refuzon çfarëdo instrumentalizimi të letërsisë, qoftë ky politik, ideologjik, religjioz etj., por nuk e privon atë nga funksioni i saj formues etik, kombëtar, historik etj.

Që me shfaqjen e tij në vitet '60 Rexhep Qosja solli një kualitet të ri në mendimin tonë kritik. Mirëpo, shikuar nga perspektiva e sotme mund të thuhet lirisht se Rexhep Qosja është themelues i një shkolle të studimit historiko-letrar të letërsisë shqipe. Jo vetëm si studiues i letërsisë, por edhe si ligjërues i saj para studentëve, si themelues dhe udhëheqës i studimeve pasuniversitare në Degën e Letërsisë Shqipe pranë Fakultetit Filologjik, të cilat i udhëhoqi për më se 20 vjet, si mentor i shumë kandidatëve për teza të doktoratës dhe të mgjistraturës, si drejtues shumëvjeçar i një institucioni të rëndësishëm shkencor, siç është Instituti Albanologjik etj., dhe përsëri si njeri që punën krijuese e vë në plan të parë, kurse penën e ka aleaten e vet më besnike, ai, tok me nxënësit e tij, ka krijuar një **shkollë të vetën kritike e historiko-letrare**, që mbështetet **mbi parimet e poetikës strukturale historike**,⁴ por që përfiton edhe nga përvoja e metodave të tjera të studimit të letërsisë, i bindur se kombinimi i rrafshëve (sinkronik dhe diakronik) dhe i qasjeve (të jashtme dhe të brendshme) e tregon përpikërisht "stilin e epokës".⁵

Në tekstet e tij kritike, eseistike dhe historiko-letrare që ka shkruar e botuar deri më sot, që kapin dhjetëra vëllime e mijëra faqe, nuk ka mbetur pa

⁴ R e x h e p Q o s j a, *Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I*, "Rilindja", Prishtinë 1984, f.9.

⁵ P o a t y, f.7.

u prekur a trajtuar pothuajse asnjë problem i rëndësishëm i letërsisë shqipe dhe as pa u vlerësuar ose së paku përmendur asnjë shkrimtar po ashtu i rëndësishëm i kësaj letërsie.

Sot askush nuk mund t'i hyjë studimit të letërsisë shqipe dhe veçanërisht studimit historiko-letrar të saj - e aq më pak të pretendojë të bëjë një hap përpara në të - pa u njohur më parë me kontributin që ka dhënë Rexhep Qosja në këtë fushë, pa e konsultuar mendimin e tij dhe pa e studiuar mirë veprën e tij, për të cilën mund të thuhet se është një lloj enciklopedie e letërsisë shqipe. Siç është thënë në Tiranë - në një diskutim krijues të zhvilluar me rastin e botimit të veprës me shkrime të zgjedhura kritike "*Panteoni i rralluar*" (1988) - Rexhep Qosja e ka rrokur në studimet e tij letërsinë shqipe në ato përmasa që nuk e ka bërë asnjë studiues tjetër para tij, duke ndriçuar dimensionet kryesore të universit letrar shqiptar.⁶

Kjo vlen sidomos për veprat "*Kontinuitete*", "*Shkrimtarë dhe periudha*", "*Prej tipologjisë deri te periodizimi*" etj., të cilat e përgatisin sintezën e madhe shkencore që do të pasojë me veprën kapitale "*Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I, II, III*".

Në veprën e tij trevëllimëshe "*Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi*", e cila bashkë me monografinë kushtuar Naim Frashërit me titull "*Porosia e madhe*" paraqet kurorën e punës së tij të deritashme në fushën e historisë së letërsisë, pos çështjeve të përgjithshme teorike si: struktura hapësinore, struktura kohore, struktura gjuhësore, struktura figurative e ritmike etj., të trajtuara në vëllimin e parë me titull "Poetika", autori bën edhe portretet e 15 shkrimtarëve, sipas tij, më përfaqësues, të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, përkatësisht të romantizmit shqiptar, duke filluar që nga Naum Veqilharxhi, Jeronim de Rada, Anton Santori, Thimi Mitko, Jani Vreto, Pashko Vasa, Gavril Dara i Riu dhe Konstandin Kristoforidhi, që trajtohen në vëllimin e dytë e gjer te Zef Serembe, Naim Frashëri, Ndue Bytyçi, Sami Frashëri, Filip Shiroka, Zef Skiroi dhe Ndre Mjedja, që zënë vend në vëllimin e tretë të kësaj vepre.

Teoricieni i njohur rus M.Bahtin thotë në një rast se historia e letërsisë është një lloj përralle për të kaluarën letrare. Ç'do të thotë kjo? Nëse e pranojnë si të vërtetë këtë pohim, si edhe pohimin tjetër të ngjashëm se historiani i letërsisë rrëfen përjetimet e shpirtit të vet mes kryeveprash, atëherë s'ka si të mos pajtohem me kërkesën se ai duhet të dijë të rrëfejë bukur dhe ta mbajë të gjallë kërshërinë e lexuesve. Kur e lexon "Historinë e letërsisë shqipe" dhe "Porosinë e madhe", por edhe veprat e tjera të Rexhep Qosjes, në të cilat takohen argumenti dhe elokuenca, erudicioni dhe invencioni, logjika e rreptë shkencore dhe shprehja e bukur gjuhësore, shumë herë me ngjyrim

⁶ Prof. Alfred Uçi, *Ndriçim i dimensioneve të universit letrar shqiptar*, në "Drita", Tiranë, 20.XI.1988, f.6.

emocional, lexuesit i kujtohen fjalët që thotë Gëteja në "Faustin" e tij se të bisedosh me një mjeshtër është edhe e dobishme, edhe e këndshme.⁷

Akademik Rexhep Qosja hyn pa dyshim në radhën e atyre njerëzve, të cilët, me veprën e vet, qysh për së gjalli i bëjnë vend vetes në panteonin e vlerave kombëtare. Pavarësisht nga fakti se herë-herë mund të mos pajtohemi me mendimin e tij politik që, për shkak të qëndrimit të theksuar kritik dhe stilit të rreptë e sarkastik, mund të duket ngapak intolerant e autoritar, pavarësisht nga fakti se si kritik letrar dhe studiues i letërsisë ai i ka edhe shkarjet dhe mëkatet e veta, ashtu siç i kanë pasur dhe i kanë, më në fund, të gjithë kritikët letrarë (edhe ata më të mëdhenjtë) kudo në botë, për të dhe punën e tij mund të flitet vetëm me respekt dhe assesi ndryshe.

Njerëzve si Ai në botën e qytetëruar u hiqet kapela, kurse tek ne jo rrallë ndodh e kundërta. Ne dimë, si askush tjetër, të hedhim baltë publikisht, mbi fytyrat e njerëzve tanë më të merituar; t'i mohojmë ose minimizojmë mynxyrshëm krijuesit më të spikatur të vlerave tona shpirtërore, vepra e të cilëve ka hyrë tashmë në fondin e kulturës kombëtare e, madje, edhe të asaj botërore. Përsë? Përgjigjen ndaj kësaj pyetjeje do të mund ta gjenim te një mendim i hershëm i filozofit të madh francez, Volterit, i cili e kishte zakon të thoshte (kuptohet jo pa ironi) se krijuesit e mëdhenj, sikurse edhe njerëzit e mëdhenj në përgjithësi, të cilët rëndom shohin më larg se të tjerët, u ekspozohen, pos shumë sfidave të tjera, edhe dy rreziqeve të pashmangshme: xhelozisë së mediokërve dhe interpretimit të budallenjve!

Në 60-vjetorin e lindjes, profesor Qosja, siç e quajnë jo vetëm studentët dhe ish-studentët e tij, por një popull i tërë, është ende vital si njeri dhe aktiv si krijues. Në këto vitet e fundit, nën ndikimin e rrethanave të krijuara në Kosovë dhe te shqiptarët në përgjithësi, ai pothuajse ka hequr dorë nga vokacioni i tij parësor - studimi historiko-letrar i letërsisë shqipe dhe i është përkushtuar, me zell e përkushtim të veçantë, çështjes kombëtare shqiptare - elaborimit teorik të saj, por edhe angazhimit praktik rreth saj si intelektual - duke derdhur në të, si gjithmonë, tërë energjitë e veta krijuese. Nuk do mend se kjo është një punë shumë e çmueshme dhe e dobishme - me dobi të shumëfishtë - por që autorin e ka larguar përkohësisht nga projekti i tij i madh jetësor, që ua ka premtuar kaheerë lexuesve - Historia komplete e letërsisë shqipe.

Shpresoj se shpreh bindjen dhe disponimin e një numri të madh njerëzish - të të gjithë atyre që ia duan të mirën letërsisë dhe kulturës shqiptare e, pse jo, edhe kombit shqiptar - nëse them se 60-vjetori i lindjes së akademik Rexhep Qosjes është një përvjetor i kulturës sonë. Le të na lejohet, prandaj, që mikut dhe profesorit tonë të çmuar, t'i urojmë, siç është zakon në këso rastesh,

⁷ Cituar sipas dr. J o r g o B u l o s, *Jo thjesht një profesion, por një mision*, "Drita", 20.XI.1988, f.7.

shëndet të mirë, jetë të gjatë dhe punë të frytshme krijuese, me dëshirë e shpresë që në Kosovë dhe në të gjitha viset shqiptare të krijohen sa më parë kushtet për punë normale - me çka nënkuptojmë shkëputjen e Kosovës prej Serbisë dhe pavarësimin e plotë të saj - në mënyrë që prof. Qosja ta vazhdojë punën në projektin e tij jetësor - Historia e letërsisë shqipe prej fillimeve e deri më sot, duke bërë edhe me letërsinë e shekujve të tjerë - dhe veçanërisht të këtij shekulli - atë që ka bërë me letërsinë shqipe të shekullit të nëntëmbëdhjetë, përkatësisht me letërsinë shqipe të Rilindjes Kombëtare, e cila paraqet "mëmën e madhe në të cilën derdhen rrjedhat më të rëndësishme të së shkuarës letrare dhe kulturore dhe prej së cilës dalin parimet bazë të së ardhmes letrare dhe kulturore në gjuhën shqipe".⁸

PËRFUNDIM

Akademik Rexhep Qosja (1936) është pa dyshim njëri nga shkrimtarët dhe intelektualët më eminentë shqiptarë të kohës sonë.

Kritik letrar e historian i letërsisë; prozator e dramaturg; eseist e publicist; intelektual kritik dhe polemist i veçantë, Rexhep Qosja është një personalitet i gjithanshëm e poliedrik, kurse vepra e tij letrare dhe shkencore është e gjerë, e shumanshme dhe e madhe - edhe si vëllim, edhe si vlerë - dhe me ndikim të madh jo vetëm në jetën letrare e kulturore, por edhe në rrjedhat jetësore shqiptare në përgjithësi.

Në një periudhë relativisht të shkurtër prej më pak se 30 vjetësh ai arriti të botojë më se 20 vepra të vëllimshme letrare, shkencore dhe publicistike, shumica e të cilave janë pritur me interesim jo të zakonshëm në hapësirën e gjithmbarshme kulturore shqiptare, kurse disa prej tyre janë përkthyer dhe botuar edhe në gjuhë e vende të tjera, ku po ashtu kanë zgjuar interesimin e lexuesve dhe të kritikës letrare.

Edhe pse u mor edhe me krijimtari të mirëfilltë letrare - me prozë e dramaturgji, gjini këto në të cilat arriti po ashtu rezultate të shënuara (romani i tij "Vdekja më vjen prej syve të tillë" dhe vepra dramatike "Mite të zhveshura" hyjnë në radhën e veprave më të çmuara të letërsisë së sotme shqipe), profili i tij kryesor mbetet, megjithatë, ai i studiuesit të letërsisë.

Në shkrimet e tij kritike, eseistike dhe historiko-letrare pothuajse që nga fillimi dhe veçanërisht nga viti 1968 e këndeje, kur fillon procesi i integritimit kulturor dhe shpirtëror shqiptar, i ndërprerë përsëri në vitin 1981, artikullohet qartë vetëdija mbi ekzistencën e një letërsie dhe të një kulture kombëtare, që ka një traditë të përbashkët e unike dhe që krijohet në një gjuhë të përbashkët letrare. Është e kuptueshme, prandaj, që në veprat e tij, duke filluar që nga "Dialogë me shkrimtarët" e këndeje, hasen pranë e pranë Migjeni dhe Esad

⁸ R e x h e p Q o s j a, *Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I*, f.11.

Mekuli, Hivzi Sulejmani dhe Jakov Xoxa, Josip Rela dhe Kolë Jakova, Anton Pashku dhe Ismail Kadareja e kështu me radhë.

Në analizën e veprës letrare ai nisët prej tri aspektesh kryesore: 1)nga aspekti i gjenezës shoqërore, kombëtare dhe historike të veprës, pra i gjenezës së frymëzimit të saj; 2)nga aspekti semantik-estetik (si ekziston vepra estetikisht dhe si funksionon struktura e saj), që është aspekti kryesor dhe 3)nga aspekti i konkretizimit ose i receptimit të saj; i jehonës që ka bërë dhe i ndikimit që ka ushtruar vepra te lexuesit dhe te krijuesit e tjerë bashkëkohës apo të mëvonshëm.

Nga këto pozita ai e ka shikuar letërsinë shqipe të romantizmit si formacion stilistik në veprën e tij madhore "Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I,II,III" (1984-1986) dhe në këtë kuadër edhe veprat dhe autorët që e konstituojnë poetikën e saj, si edhe në monografinë kushtuar krijimtarisë së bardit të romantizmit shqiptar, Naim Frashërit, me titull "Porosia e madhe" (1986).

Veprën letrare ai e konsideron si një entitet specifik, që ka ligjëroritë e veta të krijimit dhe të komunikimit me lexuesit, por pa e shkëputur nga konteksti shoqëror, politik, kulturor dhe shpirtëror i kohës kur lind dhe shfaqet ajo.

Me emrin e tij lidhet konsolidimi i kritikës letrare në letërsinë shqipe në Kosovë dhe modernizimi i shkencës letrare shqiptare në përgjithësi.